




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa:rr."Adem Jashari" pn, www.kk.rks-gov.net; e-mail:zip_gjilan@hotmail.com,tel.0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, nënparagrafi 2.3, 2.4 dhe 2.5 i Ligjit nr.03/L-226 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 38, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 i Statutit të Komunës së Gjilanit, në përputhje me PZHU dhe PRRU "Fidanishte" si dhe me Vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së të dt.28 dhe 29 Shtator 2011, për aprovimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës së Gjilanit për këmbimin e pronave shoqërore me prona komunale, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur me datë 09.02.2012, miraton këtë :

V E N D I M

Për lejin e këmbimit të pronave të paluajtshme komunale me prona të paluajtshme shoqërore të cilat janë në menaxhim të AKP-së

I.

Me këtë Vendim, Komunës së Gjilanit i **Lejohet këmbimi** i pronave të paluajtshme komunale si kompensim për pronat shoqërore të kërkuara nga AKP-ja, për të cilat Kuvendi Komunal i Gjilanit me Vendimin Nr.01.5684 të dt.27.04.2011 i ka Shpallur Zonë me Interes të Përgjithshëm Publik, me qëllim të realizimit të PZHU dhe PRRU "Fidanishte" me dedikim për ndërtimin e një Shkolle të Mesme me të gjitha objektet përcjellëse të saj me karakter Socio- Kulturor "Don Bosko" në Gjilan, ngastrat kadastrale: 1961-1, 4961-2, 1964-3, 1961-10 dhe 1961-3, me sipërfaqe të përgjithshme të këtyre ngastrave prej 15317 m², te vendi i quajtur "Fidanishte", ZK-Gjilan, pronarë i të cilave janë : Kombinati Bujqësor Industrial – Gjilan dhe N.SH. "Mekanizmi" –Prishtinë.

II.

Autorizohet Kryetari i Komunës që në emër të Komunës së Gjilanit të lidhë Marrëveshjet për Këmbim të pronave të paluajtshme komunale me Autoritetet e AKP-së, nën menaxhimin e të cilave janë pronat shoqërore të cilat duhet të këmben. Këmbimi bëhet si kompensim i cili është bazuar në vlerën e tregut të paluajshmërive e përcaktuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronave në kuadër të Departamentit të Tatimit në Pronë të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave në pajtim me Ligjin për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (Nr.03/1-139).

III.

Me Marrëveshjen e parë duhet të bëhet këmbimi i këtyre ngastrave :

1. Ngastra kadastrale P-70403020-00884-3, lloji i pronës-parcelë, zona-urbane, shfrytëzimi aktual-bujqësore, te vendi i quajtur "Ilina Glava", me sipërfaqe prej 62485 m², e evidentuar në Certifikatën mbi të Drejtat e pronës së paluajtshme UL-70403020-00350, ZK- Livoq i Ulët, në emër të pronarit : P.SH. Kuvendi i Komunës Gjilan,
2. Ngastra kadastrale P-70403045-00809-2, lloji i pronës- parcelë, zona – rurale, shfrytëzimi aktual-bujqësore, te vendi i quajtur "Golemi Rid", me sipërfaqe prej 76585 m², e evidentuar në Certifikatën mbi të Drejtat e pronës së paluajtshme UL-70403045-00055, ZK-Nasalë në emër të pronarit : P.SH. Kuvendi i Komunës Gjilan.

Këto ngastra këmbehen me :

3. Ngastra kadastrale P-70403013-01964-3, lloji i pronës- parcelë, zona-urbane, shfrytëzimi aktual-tokë e ndërtimit, vendi i quajtur “ Fidanishte”, me sipërfaqe prej 161 m², e evidentuar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme L.Nj. 1730, ZK-Gjilan, në emër të pronarit : P.SH. Kombinati Bujqësor Industrial Gjilan,
4. Ngastra kadastrale P-70403013-04961-2, lloji i pronës-parcelë, zona-urbane, shfrytëzimi aktual-bujqësore, vendi i quajtur “ Fidanishte”, me sipërfaqe prej 3666 m², e evidentuar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme L.Nj. 1730, ZK-Gjilan, në emër të pronarit : P.SH. Kombinati Bujqësor Industrial Gjilan,
5. Ngastra kadastrale P-70403013-01961-1, lloji i pronës-parcelë, zona-urbane, shfrytëzimi aktual-bujqësore, vendi i quajtur “ Fidanishte”, me sipërfaqe prej 9798 m², e evidentuar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme L.Nj. 1730, ZK-Gjilan, në emër të pronarit : P.SH. Kombinati Bujqësor Industrial Gjilan.

V.

Me Marrëveshjen e dytë duhet të bëhet këmbimi i këtyre ngastrave :

1. Ngastra kadastrale P-70403020-00884-4, lloji i pronës- parcelë, zona-urbane, shfrytëzimi aktual-bujqësore, vendi i quajtur “ Ilina Glava”, me sipërfaqe prej 14100 m² e evidentuar në Certifikatën mbi të Drejtat e pronës së paluajtshme UL-70403020-00350, ZK-Livoq i Ulët, në emër të pronarit : P.SH. Kuvendi i Komunës Gjilan.

Kjo ngastër këmbehet me :

2. Ngastra kadastrale P-70403013-01961-10, lloji i pronës- parcelë, zona-urbane, shfrytëzimi aktual-tokë e ndërtimit, vendi i quajtur “ Fidanishte/ Pjesa e re”, me sipërfaqe prej 72 m², e evidentuar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL-70403013-09274, ZK- Gjilan, në emër të pronarit: NSH “ Mekanizmi”- Prishtinë,
3. Ngastra kadastrale P-70403013-1961-3, lloji i pronës-parcelë, zona-urbane, shfrytëzimi aktual-tokë e ndërtimit, vendi i quajtur “ Fidanishte/ Pjesa e re”, me sipërfaqe prej 1620 m², e evidentuar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL-70403013-09274, ZK-Gjilan, në emër të pronarit : NSH “ Mekanizmi “ – Prishtinë.

V.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-Gjilan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.

VI.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

Nr.01 16/16468
Gjilan, më 09.02. 2012

Kuvendi i Komunës

Izmi ZEKA, Kryesues